

Byroja e
Kuvendit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SHËRBIMI ADMINISTRATIV

Nr. 64 prot.

Tiranë, më 08/01/2026

Lënda: Informacion mbi detajimin e buxhetit të vitit 2026

**BYROSË SË KUVENDIT
SEKRETARIATIT PËR BUXHETIN**

I nderuar Zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ligji nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026" i ka akorduar Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2026, një fond buxhetor prej 2.121 milion lekë, që përbën 0,42 % të shpenzimeve të buxhetit të shtetit.

Ky ligj, përcakton kufijtë e shpenzimeve në nivel programi, për shpenzimet korente dhe kapitale, për tre vitet e ardhshme, 2026-2028, por në këtë informacion, do të fokusohemi hollësisht për vitin buxhetor 2026, vlerat e të cilit janë më të larta se vitet e kaluara, por referuar kërkesave të drejtuesve të shërbimeve, nuk plotësohen nevojat e llogaritura.

Buxheti i Kuvendit ka pësuar rritje në vite, ndryshime të cilat paraqiten grafikisht në grafikun nr.1:

Grafiku nr.1



Si shihet dhe nga grafiku, buxheti i Kuvendit ka pësuar rritje nga viti në vit. Kjo rritje argumentohet me rritjen e numrit të punonjësve, e cila shoqërohet me kosto financiare në shpenzimet operative për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, por dhe për shkak të intensifikimit të aktivitetit parlamentar, diplomacisë parlamentare, axhendës evropiane, zgjerimit të strukturave në funksion të mbështetjes së punës së anëtarëve të parlamentit etj.

Gjatë procesit të planifikimit të nevojave buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, me fokus vitin 2026, drejtuesit e programeve buxhetore përcaktojnë treguesit e performancës, për të cilët bazohen në planin e veprimit, që synon përmbushjen e objektivave të planit strategjik të Kuvendit (2025-2030).

Tabela Nr.1 Tabela e detajimit të buxhetit për vitet 2026 -2028

në lekë

Programi	Emërtimi i llogarisë	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Programi Administrativ	Shpenzime për paga	485.261.000	486.261.000	491.500.000
	Shpenzime për sigurime	78.858.000	79.858.000	81.962.000
	Shpenzime operative	215.000.000	194.358.000	189.958.000
	Transferta me jashtë	90.000	90.000	90.000
	Projekte/Investime	132.000.000	48.000.000	65.000.000
	Total	911.209.000	808.477.000	828.420.000
Programi Legjislativ	Shpenzime për paga	707.402.000	708.402.000	708.400.000
	Shpenzime për sigurime	77.600.000	77.715.000	77.602.000
	Shpenzime operative	410.456.000	361.188.000	365.588.000
	Transferta me jashtë	15.000.000	15.000.000	15.000.000
	Total	1.210.458.000	1.147.305.000	1.151.590.000
TOTAL BUXHETI		2,121.667.000	1.955.782.000	1.980.010.000


Tabela nr.1, si më sipër, paraqet buxhetin vjetor të Kuvendit (sipas viteve të buxhetit afatmesëm) të ndara në dy programet buxhetore dhe secili program buxhetor, është i ndarë në grupshpenzimet kryesore, llogaria ekonomike treshifrore.

Tabela nr.2 Tabela e projekteve të investimeve të planifikuara për vitin 2026

PROJEKTE INVESTIME (Shpenzime kapitale)	Llog. ekonomike	Vlera në lekë
Zhvillimi dhe zbatimi i një zgjidhje bazuar në inteligjencën artificiale për transkriptimin e Kuvendit	2310000	18,387,120
Blerje pajisje zyre	2310000	30,612,880
Rritje e kapaciteteve të sigurisë kibernetike	2310000	32,000,000
FV Media Hub të Kuvendit	2310000	50,200,000
Projekt "FV Media Hub të Kuvendit"	2300000	800,000
TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE		132.000.000

Ndërsa tabela nr.2 paraqet të detajuara listën e emertimeve të projekteve me shpenzime kapitale, dhe vlerat e secilit projekt, vetëm për vitin 2026.

Secili zë buxhetor, ka një peshë specifike mbi planin buxhetor vjetor të Kuvendit, dhe grafiku nr.2, paraqet këtë peshë specifike të secilit zë:



Grafiku nr. 2 Sipas grafikut nr.2, shihet që 64 % e planit vjetor të buxhetit e zënë shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve, 29% janë shpenzimet e tjera operative, të domosdoshme për funksionimin (më poshtë do të sqarojmë cilat janë këto shpenzime); 6 % janë shpenzimet kapitale dhe vetëm 1 % janë kuotat parlamentare, që paguhet për organizatat, ku Parlamenti i Shqipërisë aderon dhe merr pjesë në Asamblë të Parlamentare të tyre.

I. NUMRI I PUNONJËSVE

Ligji “Për buxhetin e vitit 2026” ka miratuar për Kuvendin, një numër prej 486 punonjës (deputetë, staf politik dhe staf administrativ), me një shtesë prej 21 punonjës.

Grafikisht, ndryshimi i numrit të punonjësve (deputetë, staf politik, staf administrativ dhe mbështetës) paraqitet si më poshtë, në grafikun nr.3:

Grafiku nr.3



Grafiku nr 3, paraqet në mënyrë krahasimore ndryshimin në rritje të numrit të punonjësve (plan dhe fakt) në vitet e fundit. Numri i planifikuar është numri që rezulton në strukturën organizative të institucionit, duke përfshirë dhe 140 deputetë, ndërsa numri faktik, është gjithnjë më i ulët, pasi një numër deputesh, të cilët kalojnë në funksionin e ministrit, nuk janë në marrëdhënie financiare me Kuvendin, por dhe vende vakante, në strukturën e stafit politik dhe administrativ, një pjesë e të cilëve janë në proces

rekrutimi.

Gjatë vlerësimit të nevojave për numrin e punonjësve për vitin 2026 dhe në vazhdim, u kërkuar disa shtesa, por ligji ka marrë në konsideratë si më poshtë :


-Me fillimin e legjislaturës së re, është shtuar (me 3) numri i komisioneve të përhershme parlamentare, gjë që është shoqëruar me shtimin e numrit të këshilltarëve dhe koordinatorëve për këto komisione (6 këshilltarë, 3 koordinatorë të komisioneve parlamentare).

-në zbatim të vendimit nr.10 datë 03.12.2025 të Byrosë së Kuvendit, në mbledhjen ku u diskutua projektbuxheti për Kuvendin, ligji i buxhetit ka shtuar 5 këshilltarë, staf politik;

- është plotësuar me burime njerëzore (planifikim në numër) struktura e re, e krijuar në kuadër të e-legislation;

- numri shtesë për krijimin e një mediaroom, nuk është parashikuar në ligjin për buxhetin e vitit 2026.

Grafiku nr.4



Grafiku nr.4 tregon përbërjen (strukturën) e numrit të punonjësve.


Deputetët zënë 29 % të numrit total;

Nëpunësit civilë (këshilltarë, drejtuës, specialistë, koordinatorë, redaktorë, etj) zënë 47 % të numrit total;Stafi politik 15 % dhe stafi mbështetës (mirëmbajtës, punëtorë shërbimi, shoferë etj) përbëjnë 9 % të numrit total

SHPENZIMET PËR PAGAT DHE KONTRIBUTE (llogaria 600 dhe 601)

Plani i shpenzimeve për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi, është në vlerë vjetore 1.349.121.000 lekë për vitin 2026 dhe përbën 64 % të planit buxhetor total të Kuvendit.

Grafiku nr.5



Grafiku nr.5 paraqet ndryshimin në rritje, nga një vit në tjetrin të shpenzimeve vjetore të planifikuara për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Plani buxhetor akordohet bazuar në numrin e miratuar të punonjësve dhe pagat bruto për secilin pozicion, ndërsa strukturat e buxhetit në institucion, analizojnë herë pas here realizimin faktik dhe në rastet e fondeve që nuk do të përdoren (numri i deputetëve që kalojnë në

funksiione qeveritare, pozicione vakante), njoftohet Ministria e Financave dhe kthehen në buxhet;

Gjatë vitit 2026, do ketë një kosto financiare (jo të ndjeshme), në rritje, të kontributeve për sigurimet shoqërore, për shkak të rritjes së pagës maksimale të sigurimeve shoqërore, duke filluar që nga janari 2026.

II. SHPENZIMET TË TJERA OPERATIVE (llogaria ekonomike 602)

Totali vjetor i këtij grup shpenzimesh është akorduar në vlerë 625.456.000 lekë ose 29% të totalit vjetor të buxhetit të Kuvendit.

- Në programin legjislativ janë akorduar dhe detajuar rreth 410.456.000 lekë (që përbën 65.6 % të totalit të këtij grup shpenzimesh) ;
- Në programin administrativ janë akorduar dhe detajuar rreth 215.000.000 lekë (që përbën 34.3 % të totalit të këtij grup shpenzimesh) ;

Në nëngrupin e parë të këtyre shpenzimeve, përfshihen kompensimet ligjore financiare të anëtarëve të parlamentit, shpenzime të udhëtimeve jashtë shteti, të pritje përcjellje, të pagesave të përkthyesve dhe ekspertëve të jashtëm, të nevojshëm për komisionet e përhershme, të posaçme dhe hetimore; të tjera të nevojshme për të siguruar një funksionim normal të Kuvendit.

Në nëngrupin e dytë, përfshihen shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve të teknologjisë si sistemi audio video, sistemi elektronik i votimit, sistemi e-parlament, mirëmbajtje e strukturës virtuale VDI, mirëmbajtje sistem BCC, dhomës së serverave, etj., mirëmbajtje të zyrave dhe pajisjeve të zyrave, shpenzimet utilitare, shpenzime për blerje kancelarie, materiale elektrike, higjeno-sanitare, e të tjera që konkretisht paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tab.nr.3 Tabela e detajimit të shpenzimeve të llogarisë ekonomike 602, shpenzime të tjera operative

Nr	Emërtimi i shpenzimit	Programi legjislativ	Programi administrativ	ne % ndaj totalit të shpenzimeve të programit perkates	ne % ndaj totalit të buxhetit të Kuvendit
a	b	1	2	3	4
1	Shpenzime kompensimi për parlamentarët	283.000.000	x	24%	14.2%
2	Shpenzime për udhëtime jashtë shteti (dieta, akomodim, bileta)	83.906.000	x	6.9%	4%
3	Shpenzime pritje, përcjellje, dhurata etj	23.500.000	x	1.9%	1.1%
4	shpenzime për ekzekutim vendime gjyqësore	1.000.000	x	0.08%	0.04%
5	shpenzime për konferenca Kuvendi dhe takime të KKiE	8.280.000	x	0.6%	0.4%
6	Shërbime të printimit	1.100.000	X	0.09%	0.05%

7	Shpenzime per pagesa per experte te jashtem	2.000.000	x	0.16%	0.09%
8	Shpenzime te Shërbimit të IT për mirëmbajtje sisteme elektronike si më poshtë:	x	90.607.661	9.9%	4.2%
.	mirëmbajtje sistemi e parlament	x	12.206.160	x	x
.	mirëmbajtje sistemi elektronik i votimit	x	10.080.000	x	x
.	mirëmbajtje sistemi audio video	x	17.111.111	x	x
.	mirëmbajtje infrastrukturës virtuale VDI	x	8.094.060	x	x
.	Mirembajtje dhomës së serverave	x	2.250.000	x	x
.	Mirëmbajtje sistem BCC	x	8.500.000	x	x
.	Blerje shërbim testimi te sigurise	x	2.000.000	x	x
.	Shërbim mirëmbajtje transkriptimit	x	8.000.000	x	x
.	blerje licensa	x	2.800.000	x	x
.	blerje tonera	x	3.747.000	x	x
.	mirëmbajtje fotokopje	x	1.400.000	x	x
.	Blerje te shërbimeve online hosting	x	1.000.000	x	x
.	të tjera	x	13.419.330	x	x
9	Shpenzime të shërbimit të mirembajtjes zyra e te tjera pajisje	x	41.990.000	4.6%	1.9%
.	Shpenzime të kancelarisë, materiale higjieno sanitare, elektrike, hidraulike	x	6.400.000	x	x
.	Energji elektrike dhe ujë	x	11.350.000	x	x
.	shpenzime të telefonisë fikse	x	1.500.000	x	x
.	Siguracion ndertese	x	6.500.000	x	x
.	Shpenzime mirembajtje zyra, sisteme ngrohje ftohje, gjeneratore, e pajisje te tjera zyre, dekorim etj	x	16.240.000	x	x
10	Shpenzime të transportit	x	26.066.390	2.8%	1.2%
11	Shpenzime për punonjës të perkohshem (miratuar me vkm)	x	15.000.000	1.6%	0.7%
12	Shpenzime trajnimi dhe workshop	x	4.320.000	0.4%	0.2%
13	shpenzime për ekzekutim vendime gjyqësore	x	14.000.000	1.5%	0.6%
14	Shpenzime të shërbimit të komunikimit (abonime, foto e albume aktivetesh etj)	x	6.590.000	0.7%	0.3%
15	dieta per stafin (shoferë)	x	2.000.000	0.2%	0.09%
16	shpenzime për materiale shtypshkronje	x	1.297.200	0.1%	0.06%

Për vitin 2026, janë vlerësuar me rritje shpenzimet për udhëtimet jashtë shteti, për pritje e përcjellje, për mirëmbajtjen e sistemeve të IT, etj, **por në buxhet janë detajuar më pak pasi tavani në shpenzimet operative në programin legjislativ është 30 milion më pak sesa nevojat tona në projekt-buxhetin afatmesëm.**

Detajimi i shpenzimeve për mallra e shërbime, pasqyrohet në regjistrin e prokurimeve, sipas vlerave, afateve dhe brenda planit buxhetor për vitin 2026.

Ky regjistër depozitohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Sipas udhëzimit të zbatimit të buxhetit, në rast të nevojave të Institucionit, rishpërndarja e shpenzimeve ndërmjet nënzërave të një llogarie buxhetore (që paraqiten në tabelën e mësipërme), brenda llogarisë ekonomike që përfaqësojnë, bëhet nga nëpunësi Autorizues, pas një analize që i paraqet nëpunësi zbatues dhe Drejtuesi i programit buxhetor.

Ndërsa, nevoja e kalimit të fondeve të lira nga një program buxhetor në tjetrin, nga një zë buxhetor (llogari ekonomike) në tjetrin, nga një produkt në tjetrin (identifikohen me kode), kërkon miratimin përkatës të KM dhe Ministrisë së Financave.

- **Shpenzime për kuota parlamentare e të tjera:**

Kuvendi i Shqipërisë është anëtar me të drejta të plota në organizata shumëpalëshe ndërkombëtare dhe asamblatë përkatëse të këtyre organizatave. Ky anëtarësim shoqërohet me të drejta e detyrime të ndërsjellta, ndër të cilat dhe detyrimi për pagesën e kuotizacionit vjetor.

Fondi prej 15 milion lekë për vitin 2026 është akorduar sipas kërkesave të Kuvendit.

Organizatat për të cilat Kuvendi paguan këto detyrime janë OSBE, PABSEC, IPU, NATO, PAM, AP e Frankofonisë dhe Grupi 12+.

Gjithashtu, në këto transferta përfshihet dhe pagesa vjetore e abonimit në European Law Journal.

- **Shpenzimet Administrative Kapitale.**

Në total për vitin 2026 janë akorduar 132 milion lekë, që përbëjnë afro 6.2 % të totalit të buxhetit vjetor. Emërtimi i projekteve dhe vlerat përkatëse janë renditur në tabelën nr.2, sa më sipër, ndërsa shpjegimi i nevojës jepet shkurtimisht në vazhdim:

Rritje e kapaciteteve të sigurisë kibernetike, 32 milion lekë

Projekti përfshin kosto të bazuara në tri kolona:

- a. furnizim, vendosje të infrastrukturës për sigurinë kibernetike, që janë pajisje fundore, pajisje të perimetrit, infrastrukturë *hardening*, produkte të analizës, shërbime *subscription* etj.;
- b. kostot për ngritjen dhe implementimin e standardeve të sigurisë, duke u orientuar drejt standardeve ISO/NIST;
- c. kostot për trajnime, rritje të kapaciteteve teknike dhe të ekspertizës.

Synohet që nëpërmjet këtij projekti të vendoset në punë SOC me produkte XDR/XSOAR, të cilat krijojnë sigurinë në reagimin kibernetik.

Transkriptimi i të dhënave Audio-Video të Kuvendit bazuar në Inteligjencën Artificiale, 18.3 milion lekë

Është fond i akorduar në vitin 2025, por jo i trashëgueshëm. Një pjesë e pagesës së këtij investimi, prej 30 milion lekë ka kaluar në vitin 2025 dhe diferenca do të kryhet në vitin 2026. Duke qenë se projekti, instalimi, konfigurimi, testimi e trajnimi do të kërkojnë kohë që e tejkalojnë afatin 31.12.2025, kjo kontratë ka shtrirë efektet edhe në vitin 2026.

Media Hub i Kuvendit me shërbime të Integruara të Inteligjencës Artificiale, 50.2 milion lekë investimi dhe 0.8 milion lekë projekti

Media Room-i është menduar të jetë një qendër e integruar multimediale brenda Kuvendit të Shqipërisë, e konceptuar si një "redaksi televizive" profesionale, që funksionon në mënyrë të përhershme dhe bashkëpunon ngushtë me RTSH-në për transmetimin në kanalin RTSH Kuvend. Për këtë synohet të ngrihet një drejtori e re (*Media-Room*) pranë Shërbimit të Informacionit dhe Dokumentacionit, e cila të ketë rol të trefishtë:

- Informues: të përcjellë në mënyrë transparente punën parlamentare për qytetarët.
- Analitik: të shpjegojë proceset legjvënëse, reformat dhe ndikimet e tyre.
- Edukues: të ndihmojë qytetarët të kuptojnë funksionet dhe rolin e Kuvendit.

Fillimisht parashikohet të nisë puna me:

- Strukturë të reduktuar redaksie me staf minimal.
- Prodhim të përmbajtjeve bazike: transmetime live, kronika, intervista.
- Ngritjen e sistemit editorial, organizativ dhe rrjedhës së punës.
- Bashkëpunim i plotë me RTSH-në, për transmetim dhe arkivim të materialeve.

Qëllimi i programacionit televiziv të kanalit parlamentar është të ofrojë një pasqyrë të plotë, të strukturuar dhe të kuptueshme të veprimtarisë së Kuvendit për publikun e gjerë. Programet duhet të jenë të balancuara ndërmjet informimit të menjëhershëm, analizës së thelluar, edukimit qytetar dhe transparencës institucionale.

Ka dy komponentë kryesorë (1 dhe 2):

1. Studio televizive moderne

- Prodhim të plotë video/audio për TV Parlamentar.
- Arkivim dhe publikim online në kohë reale.
- Integrim të menjëhershëm me RTSH Kuvend dhe platformat sociale të Kuvendit.

2. Platformë publike televizive e Kuvendit, e integruar me shërbimet AI

- Transmetime Live dhe Multiplatformë: seanca plenare dhe mbledhje komisionesh, me komentim opsional, titrim dhe gjuhë të shenjave.
- Përmbledhje dhe analiza: kronika ditore dhe javore, përmbledhje tematike mbi çështje ligjvënëse dhe debate, të transmetuara në RTSH Kuvendi, online dhe ne rrjete sociale.
- Arkiv Digjital i Indeksuar
- Shërbime për Media dhe Deputetë
- Debate dhe Interaktivitet
- Databazë Historike dhe Kulturë Parlamentare
- Multimedia dhe Platforma Online

Blerje pajisjesh në vlerë 30 milion lekë

Në këtë zë janë planifikuar blerje karrige dhe poltronë për sallën plenare, sallën e Byrosë, tapete dhe artikuj të tjerë. *Gjithashtu 3.6 milion këtu janë llogaritur për detyrimin e pagesës së TVSH-së si rezultat i marrëveshjes së projektit PACEP II.*

Faleminderit për vëmendjen Tuaj,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ

